



REPUBLIKA E KOSOVË - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. De.D. Dep.	DPKI
Nr. llog. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Pr. Prot.	03-02/4264/16
Prishtine	14/11/2016

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.11.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2959/16, për z. Emri Lladrovci, Anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas, për shkak se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit publik, me këtë rast është shmangur gjendja e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Emri Lladrovci, Anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.P.N "Er - Com", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas të cilës ai është njoftuar me fakte për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, është deklaruar se do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për tu larguar nga njëri funksion, brenda afateve ligjore të Agjencisë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/4159/16), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit Anëtar i Kuvendit Komunal në Drenas. Me këtë rast z. Lladrovci e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

